


Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 12.12.2014, nxjerr këtë:

V E N D I M

I, Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-4260-14 për znj. Nadire Vitija– Ish anetare e Bordit Drejtues të Ndërmarrjes Publike “Termokos”, për shkak se; ajo tashmë ka mbaruar mandatin e saj dhe nuk është më në mesin e zyrtarëve të lartë publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-4260-14, pas zhvillimit të procedurës, është konstatuar se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e gjendjes së konfliktit të interesit.

Pas zhvillimit të procedurave shihet se znj. Nadire Vitija tashmë nuk e ushtron funksionin si zyrtare e lartë – Anëtare e Bordit të Ndërmarrjes Publike “Termokos”, sepse nga data 30 qershor 2014 asaj i ka përfunduar mandati në këtë Bord. Ndërkohë që dhe me datën 23 korrik 2014 z.Vitija ka bërë edhe deklarinimin e pasurisë pas largimit nga funksioni publik (DP-03-6020/14).

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit
Hasan Preteni

